



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
ASAMBLEJA

Tiranë, më 20.10.2023

Prot 660/15

Vendim nr. ⁶⁰ datë 20 tetor 2023
Për zgjedhjen e Zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave

Mbështetur neneve 8 e 11 të Ligjit nr. 53/2019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë* dhe neneve 14, 15, 16, 17 e 18 të Statutit; sot, më datë 20.10.2023, u zhvillua mbledhja e Asamblesë së Akademisë së Shkencave për zgjedhjen e Kryetarit dhe të Zëvendëskryetarit të saj, me rend dite të miratuar prej saj me vendimin e datës 11.9.2023.

Pasi u verifikua plotësimi i kuorumit sipas parashikimit në nenin 8 pika 4 të Ligjit nr. 53/2019 sipërcituar dhe në nenin 17 pika 2 të Statutit, dhe rezultoi se të pranishëm fizikisht në mbledhje janë 44 anëtarë, si dhe me votimin në distancë të 9 anëtarëve sipas nenit 10 pika 3 të Statutit; gjithësej 53 nga 54 anëtarë;

Pas ngritjes së komisionit të zgjedhjeve sipas nenit 17 pika 2 të Statutit dhe paraqitjes së relacionit të komisionit teknik;

Pasi konstatoi se dokumentacioni i nevojshëm, sipas parashikimeve në nenin 16 të Statutit, nga kandidati i regjistruar për konkurrim për funksionin e Zëvendëskryetarit akad. Vasil S. Tole është i plotë;

Pas kryerjes së procesit të zgjedhjeve me votim të fshehtë e shpalljes së rezultatit nga komisioni i zgjedhjeve, sipas procesverbalit bashkëngjitur;

Vendosi:

1. Zgjedhjen akad. Vasil S. Tole në detyrën e Zëvendëskryetarit të Akademisë së Shkencave për katër vitet e ardhshme, me 50 vota pro, 3 kundër dhe asnjë abstenim;
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Shaban Sinani
Sekretar shkencor